



KËRKESË
Nr. 3084, datë 3.4.2019

PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR DËNIM ADMINISTRATIV, NDAJ SUBJEKTIT
“RADICINA” sh.p.k.

ISHMPUT-ja, Qendër, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin administrativ përfundimtar të Komisionit të Shqyrtimit të Ankimit, nëpërmjet shërbimit postar, është kthyer njoftimi i institucionit tonë, duke u konfirmuar me shënimin: adresë e pasaktë.

Sa më sipër, ISHMPUT-ja, Qendër, bën njoftimin publik të vendimit të dënimit administrativ, respektivisht për subjektin si më poshtë:

“RADICINA” sh.p.k.,

KRYEINSPEKTORI
Armando Lamaj



VENDIM
Nr. 1033, datë 1.2.2019

I KOMISIONIT TË ANKIMIT

Në bazë të pikës 2 të nenit 51 të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të VKM-së nr. 103, datë 4.2.2015, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve”, të ndryshuar me vendimin nr. 338, datë 6.6.2018, të Këshillit të Ministrave dhe Ankimit për vendimin përfundimtar me nr. 6, datë 31.10.2018, të ISHMPU-së Qendër, ndaj subjektit “RADICINA” sh.p.k., protokolluar me nr. 6519 prot., datë 20.11.2018,

Komisioni:

Sa më sipër, nga analiza e fakteve të pretenduara nga të dyja palët arsyeton se marrja e masës administrative nga grupi i inspektimit është në përputhje me pikën “q” të nenit 38 të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar. Pasi shqyrtoi ankesën dhe masën administrative në mbështetje të pikës 4 të nenit 137 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

Lënien në fuqi të vendim dënimi nr. 6, datë 31.10.2018 të ISHMPUT-së Qendër, në vlerën 100 000 lekë dhe rrëzimin e ankimit të subjektit “RADICINA” sh.p.k., ndaj këtij akti administrativ.

Ky akt hyn në fuqi menjëherë.

KRYEINSPEKTORI
Armando Lamaj

Kundër vendimit përfundimtar mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë.